



**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu
Zaštitu / Department of Health and Social Welfare**

Nr. 04-553/01-2636/26
dt: 12/01/2026

Njoftim për aplikim

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga data **12.01.2026** ka hapur aplikimin për programin e bonus banimit, subvencionimin e qirasë.

Te drejtë aplikimi kanë të gjitha familjet banor rezident të komunës, që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale dhe familjet me gjendje të rënd ekonomike.

Kriteret për përcaktimin e radhës dhe përparësisë për sigurimin e banimit për personat/familjet që aplikojnë janë:

- statusi i banimit
- lartësia e të ardhurave
- gjendja shëndetësore
- invaliditeti
- struktura e familjes

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- 1.Kërkesa sipas formës standarde merret në Qendrën për Shërbime me Qytetarë;
- 2.Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
- 3.Ekstrakti i lindjes për anëtarët e familjes të parashtruesit të kërkesës;
- 4.Deklarata e bashkësisë familjare;
- 5.Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale, për familjet përfituese të ndihmës sociale;
- 6.Vërtetim nga Qendra e Punësimit për të gjithë anëtarët e familjes të papunë, mbi moshën 18 vjeçare;
- 7.Vërtetim për dëshminë lidhur me statusin e familjes së dëshmorit;
- 8.Vërtetim mbi shkollimin e rregullt;
- 9.Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo anëtarëve të familjes;
- 10.Çertifikatën apo vërtetimin që nuk posedon pronë të paluatjshme;
- 11.Vendimi i Gjykatës(për rastet dhunë në familje);
- 12.Kontratën e noterizuar me qiradhënësin;
- 13.Konfirmimi i llogarisë bankare.

Afati i aplikimit për programin e banimit është **15 ditë pune**, nga data **12.01.2026** deri **30.01.2026**.

Vërejtje: Kërkesat e parashtruara jashtë afatit të aplikimit do të refuzohen nga ana e komisionit.



u.d. Drejtor i DSHMS-së

Hekuran Rapuca